



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kultures
04.Nr.111-25643/2014
Me dt 21.08.2014

DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS SHPALL KËTË:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË AFATIN PLOTËSUES NË SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE ***"FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA"*** PËR VITIN SHKOLLOR 2014/2015

Konkursi shpallet duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës.

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kritere:

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2014/15, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2014/2015, bëhet më datën 22, 25 dhe 26 Gusht 2014 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 27.08.2014.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 28.08.2014.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|--|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (25%) 25 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (15%) 15 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (60%) 60 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Shkolla e Mesme Profesionale
 “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”
 Kaçanik

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr. Nxënësve gjithsej	Te regjistruar	Vende te lira	Nr.paraleleve
1	Elektroteknikë	1.Teknik i telekomunikacionit 2.Teknik i informatikës 3.Instalues elektrik 4.Mekatronië	24 24 24 24	0 10 10 0	24 14 14 24	1 1 1 1
2	Ekonomi	1.Asistent i marketingut 2.Banka dhe sigurime	24 24	7 9	17 15	1 1
3	Makineri	1.Transport rrugor 2.Instalues i ngrohjes qendrore 3.Instalues ujesjellsit dhe kanalizimit	24 24 24	12 11 4	12 13 20	1 1 1
4		Automekanik	24	11	13	1
5		Saldim	24	0	24	1
5	Juridik	1.Asistent Juridik	24	16	8	1
			288	90	198	12

Kaçanik më:

21.08.2014

Drejtori i DAK-së

Enver Kamishi